



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:000924  
Datë: 12.03.2024  
Numri i dokumentit: 05439023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala dhe me bashkëpunëtorin profesional Senad Lokaj, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit M.N., nga fshati ... Komuna e Gjakovës, të cilin me autorizim e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shtesave në pagë në bazë të kualifikimit, jashtë seancës, më 12 mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Paditësit M.N., nga Komuna e Gjakovës i KTHEHET në plotësim padia e parashtruar me datë 04.12.2023, që në afat prej tre (3) ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta plotësojë padinë me provën si në vijim:

- Licencën e karrierës.

II. Do të konsiderohet se është tërhequr padia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor, e në qoftë se kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë padia.

A r s y e t i m

Paditësja, në këtë gjykatë me datën 04.12.2023, përmes të autorizuarit të saj, avokat në Gjakovë, ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shtesave në pagë në bazë të kualifikimit.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, ka gjetur se e njëjta nuk është e pajisur me provat me të cilat vërtetohen pretendimet e paditëses, përkatësisht nuk ka prova me të cilën vërtetohet se paditësja është e licencuar me licencë të karrierës.

Meqenëse gjykata nuk ka mundësi të veprojë sipas padisë, në kuptim të nenit 99 par.2 dhe 102 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2024:000924  
Datë: 12.03.2024  
Numri i dokumentit: 05439023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË  
2024:000924, më 12 mars 2024

Gj y q t a r j a  
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.